



PLANI I VEPRIMIT

për Personat me Aftësi të
Kufizuara në Komunën
e Prishtinës
2018 - 2020

Shkurt 2018



A large, stylized, light blue graphic of a human figure with arms raised, set against a dark blue background. The figure is composed of smooth, rounded shapes, with a circular head and a wide, open mouth, suggesting a smile or a gesture of triumph. The figure is positioned centrally, behind the main text.

PLANI I VEPRIMIT

për Personat me Aftësi të Kufizuara
në Komunën e Prishtinës



Përmbajtja

Parathënie	_____	5
Përmbledhja	_____	6
Plani i Aktiviteteve	_____	7

Parathënie

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) përbëjnë më shumë se 10 % të popullatës në Komunën e Prishtinës të cilët janë të diskriminuar në shfrytëzimin e shërbimeve, qasjes në hapësira publike dhe në të mira të tjera të cilat ofrohen nga komuna për qytetarët e sajë. Në vitin 2013 është zhvilluar Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për një periudhë 10 vjeçare e cila ndër të tjera parasheh edhe krijimin e planeve komunale për aftësinë e kufizuar. Sidoqoftë, Komuna e Prishtinës ende nuk e ka zhvilluar planin e vet të veprimit për personat me aftësi të kufizuara, që paraqet problem në zhvillimin e aktiviteteve, si dhe në buxhetimin adekuat për plotësimin e nevojave të këtij grupi të qytetarëve. Duke pasur parasysh nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuara, personeli i komunës së Prishtinës ndërton mbi këtë planin të veprimit të sugjeruar nga HandiKos Prishtina, i cili përfshin nevojat e të gjitha grupeve të ndryshme të qytetarëve me aftësi të kufizuara. Komuna e Prishtinës ka njohur faktin se mungesa e planit të aktiviteteve ka vështirësuar gjendjen e personave me aftësi të kufizuara. Ata janë ballafaqur me kufizime në lëvizje, në qasje në shërbime, dhe me mungesë të benificioneve që do të lehtësonin jetën e tyre. Kjo thëllon

diskriminimin që u shkaktohet personave me aftësi të kufizuara, edhe pse ky diskriminim nuk është i qëllimshëm. Mungesa e bashkëpunimit të deritanishëm në mes të përfaqësuesve të strukturave të komunës dhe përfaqësuesve të personave me aftësi të kufizuara ka rezultuar me shtyrjen e përpilimit të një plani të përbashkët të veprimit i cili do të definojë mënyrat për të ofruar shërbime për të gjithë qytetarët pa pasur diskriminime të asnjë lloji. Qasja e personave me aftësi të kufizuara në shërbime dhe në të mirat e tjera, të cilat i ofron komuna, nuk mundet më të lihet pasdore.

Planin i përpiluar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara u mundëson personave të kenë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në aktivitetet ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. Ky plan i veprimit për aftësinë e kufizuar ka një definicion të gjerë duke marrë parasysh se mbulon të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuar, përfshirë ato fizike, intelektuale, dëgjimore dhe vizuale.

Përmbledhja

Plani komunal i veprimit për aftësinë e kufizuar është një dokument publik i rëndësishëm i cili përshkruan konceptet se si komuna do t'i qaset diverzitetit dhe gjithëpërfshirjes, si dhe specifikon synimet dhe planet e saj për të eliminuar diskriminim e kësaj kategorie të qytetarëve. Planet e veprimit të aftësisë së kufizuar njihen edhe si "plane për Qasje & Integrim" dhe i mundësojnë komunës të arrijë një numër të qëllimeve. Ato i asistojnë komunës që të njohë më mirë nevojat dhe prioritetet e personave me aftësi të kufizuara, si dhe i mundësojnë asaj të krijojë qasje më të lehtë për ta. Planet e veprimit për aftësinë e kufizuar e zvogëlojnë mundësinë për të diskriminuar qytetarët në bazë të aftësisë së kufizuar si dhe fokusimin e shpenzimeve në fusha të rëndësishme të lartë duke klasifikuar prioritetet. Planet e veprimit për aftësinë e kufizuar janë dokumente formale me kërkesa të veçanta të identifikuara nga vetë përfaqësuesit e personave me aftësi të kufizuara të cilat bazohen në të drejtat e njeriut. Plani aktual i veprimit është rezultat i punës së HandiKos Prishtina, pesë organizatave tjera

të shoqërisë civile, të cilat merren me aftësinë e kufizuar dhe kanë konstituencë të qartë në misionin e tyre, si dhe grupit të veçantë komunal, të themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës. Ky grup komunal ka mbuluar të gjitha drejtoritë relevante të komunës dhe ka dhënë kontribut në specifikimin dhe qartësimin e aktiviteteve të planit të veprimit. HandiKos Prishtina ka organizuar punëtori me organizatat e shoqërisë civile, gjatë të cilave ato kanë paraqitur problemet me të cilat ballafaqohen konstituentët e tyre, si dhe kanë listuar prioritetet për t'u përfshirë në planin komunal të veprimit. Pas identifikimit të prioriteteve, HandiKos Prishtina ka organizuar një sërë punëtorish tjera me përfaqësues të shoqërisë civile dhe drejtorive komunale, të përfaqësuar nga grupi komunal, për të përpiluar planin e aktiviteteve për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara.

Plani i Aktiviteteve

Aktiviteti	Kush	Kur	Kosto	Komente
Respektimi i kuotës së punësimit 50/1	Burimet njerëzore	Periodikisht	750 për shpallje	Hapja e konkurseve të veçanta për personat me aftësi të kufizuara Të përfshihen edhe shkollat dhe QMF
Të stimulohet punësimi i prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara	Burimet njerëzore	Periodikisht	0	Alokimi i pikëve ekstra
Përkrahja e ndërmarrjeve sociale që merren me aftësinë e kufizuar intelektuale	Secila drejtori veç e veç	Periodikisht		Të përkrahen ndërmarrjet sociale me grante nga komuna
Përpilimi i databazës për personat me aftësi të kufizuara	Drejtorja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale	Gjatë 2018	E hapur	Të kontraktohet një kompani për përpilim të databazës
Sigurimi i lokaleve për punën e OJQ-ve që punojnë me PAK (me çmime simbolike ose falas)	Drejtorja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale	2018	E hapur	Lokalet të sigurohen për të gjitha OJQ-të që punojnë me PAK dhe ofrojnë shërbime për qytetarë të komunës së Prishtinës. Këto lokale mos të ofrojnë vetëm zyre për OJQ-të, por edhe hapësira për zhvillim të aktiviteteve me konstituentët.

Komuna të kontraktuara të shërbimeve të OJQ-ve të licencuara për ofrim të shërbimeve	Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale	2018	E hapur	Të shqyrtohet ligji i prokurimit publik, cka ndodh në rastet kur oferton vetëm një entitet
Trajnimi i stafit të mjeksive familjare për punë me persona me aftësi të kufizuara	Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale	Vazhdim	Kosto e hapur	Të zhvillohen module të përbashkëta me OJQ-të
Evidentimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara	Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale	2018		Krijimi i mekanizmave lidhur për identifikim dhe evidentimi në lindje, vaksinim etj.
Trajnimi i prindërve të fëmijëve të shurdhër në gjuhë të shenjave	Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale	2018	Të llogaritet numri i prindërve	Aplikim me projekt për subvencion në komunë Qendra për Këshillim në Karierë
Garantimi i poenave shtesë në rast të dhënies së granteve për vetëpunësim dhe angazhim të personave me aftësi të kufizuara	Zyra ligjore	2019	E hapur	Të shqyrtohet rregullorja e brendshme e komunës
Organizimi i fushatave vetëdijësuese për pranimin e personave me aftësi të kufizuara dhe evitimin e stigmatizimit në shoqëri	Drejtoritë e komunës së Prishtinës (kabineti i kryetarit)	Vazhdim		Publikimi i materialeve vetëdijësuese, përveç fushatave ekzistuese dhe të organizohen evente dhe aktivitete me vizibilitet të madh

Adaptimi i trotuarëve për lëvizje me karroca në tërë qytetin	Drejtoria për infrastrukturës dhe investimeve kapitale	2018-2019	Të evaluohet kosto	Të identifikohen të gjitha pikat në trotuare ku nuk ka mundësi për lëvizje të lirë
Sigurimi i qasjes nëpër objekte publike për përdoruesit e karrocave	Drejtoria për infrastrukturës dhe investimeve kapitale	2018-2019	Të evaluohet kosto	Të merret parasysh raporti i Handikosit që i është dorëzuar komunës "Prishtina për të Gjitha" mbi barrierat arkitektonike në ndërtesat publike në Komunën e Prishtinës
Ndërtimi i toaleteve publike, ku PAK kanë qasje me kartelë	Drejtoria për infrastrukturës dhe investimeve kapitale	2019-2020	Të evaluohet kosto	Të shikohet ku ka arritur hulumtimi / diskutimi paraprak që është bërë për këtë çështje
Rritja e vetëdijes së pupullatës për mos-shfrytëzim të parkingjeve dhe toaleteve të dedikuara për PAK	Inspekcioni komunal	2018-2020	Të ndahet buxhet vjetor prej komunës	Të rritet efienca e policisë komunale për kontroll të parkingjeve
Subvencionimi i PAK	Drejtoria e Administratës Publike			
Të futet gjuha e shenjave në faqen e internetit të komunës	Drejtoria e administratës publike	2018	Kosto e vazhdueshme (rreth 4,000)	Inçizimi i videove dhe publikimi i vegzave në youtube Informatat të fokusohen lidhur me nevojat e personave të shurdhër

Identifikimi dhe krijimi i vendeve të punës për 10 personave me aftësi të kufizuara intelektuale	Drejtoria e administratës	Vazhdim	Kosto e publikimit	Të kushtëzohen edhe kompanitë private që ofrojnë shërbime publike për punësim të PAKI
Monitorimi dhe obligimi i prindërve për të dërguar fëmijët në vlerësim dhe në shkollën adekuate	Drejtoria për arsim	2019		Fushatë vetëdijësuese përmes mediave
Sigurimi i mësimdhënësit mbështetës, ose "asistentit të klasës, instruktorit të gjuhës së shenjave" për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim, në bazë të PIA	Drejtoria për arsim	2018-2020	Kosto e vazhdueshme të lejohet nga Ministria e Financave	Nëse nuk lejohet nga MF, të njoftohen shoqatat për avokim, përfshirë edhe protestën
Sigurimi i transportit për shkollim të mesëm të lartë fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim	Drejtoria për arsim	2018	Bazuar në lokacionin e personit me aftësi të kufizuara	Kostoja të llogaritet sipas nevojave të personave që vijojnë shkollimin e mesëm
Lirimi i PAK dhe shoqëruesit nga tarifat e transportit publik, përfshirë edhe operatorët privatë	Drejtoria për Shërbime Publike	2018	Pa kosto të nevojshme për implementim	Të ngritet çështja e liritimit edhe në linjat regjionale (FK-PR)

Të vendosen vendimet për lirim nga tarifaf e transportit urban nëpër autobusë, përfshirë edhe operatorët privatë	Drejtoria për Shërbime Publike	2018	Kosto e printimit të vendimeve dhe shpërndarja e tyre	T'u dërgohet kompanive që kërkojnë liçencë pune nga komuna dhe ata t'i shtypin vet
Numrat dhe emërtimet e linjave në autobusat urbanë të shkruhen edhe anash dhe të zmadhuara dhe të shkruhen me ngjyra të dukshme	Drejtoria për Shërbime Publike	2018	Të llogaritet kostoja	Të shqyrtohet mundësia e lajmërimit me zë nëpër autobusë
Lirimi i personave me aftësi të kufizuara nga shërbimet komunale (mbeturinat, uji, ngrohja, rryma, tatimi në pronë)	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria e financave	2018	Kosto jo direkte, humbje nga mbledhja e fondeve	Ndërmarrjet regjionale të kontaktohen për implementim të vendimit Të diskutohet me drejtorinë e financave a lejohet intervenim në sistemin e tatimit në pronë Të mundësohet zbritja e shumës së tatimit direkt në faturë Të zbritet në mënyrë progresive varësisht nga numri i anëtarëve me aftësi të kufizuara psh 25% për anëtarë me aftësi të kufizuar
Sigurimi i parkingjeve për Personat me Aftësi të Kufizuara	Drejtoria për Shërbime Publike	2019	Kosto e ngjithjes së shenjave identifikuese për parkingje	Të sigurohet nëpër rrugët ku ka parkingje publike, si dhe të rritet efektiviteti i inspektorëve kur zihen parkingjet nga makinat pa shenjën e aftësisë së kufizuar

Të lirohen PAK nga tarifat e parkingjeve private	Drejtoria e Shërbimeve Publike	2018	Pa kosto	Vetëm për makinat që kanë shenjën adekuatë
Të rinovohen hapësirat ekzistuese që përdoren nga organizatat që punojnë me personat me aftësi të kufizuara	Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Kapitale	2018	Evalumi i koston për secilën kërkesë të veçantë	Të bëhet vlerësimi i nevojave për renovim të zyrave të OJQ-ve
Të sigurohen hapësira për qëndrim ditor për Personat me Aftësi të Kufizuara	Drejtoria e Urbanizmit	2018	Të bëhet evalumi i koston	Të identifikohen ndërtesat e pashfrytëzuara në komunën e Prishtinës (lokalit të Grandi, ish drejtoria e infrastrukturës)
Të mundësohet liria e lëvizjes për PAK (pjerrinat, gjilinderat në shkallë, trotualet e ngarkuara me makina, liftat)	Drejtoria e Urbanizmit	2018-2020	Evalumi i koston	Të vazhdohet me adaptim të objekteve ekzistuese dhe të mos bëhet pranimi teknik nëse nuk plotësohen kriteret e lëvizjes së lirë
Lirimi i PAK nga tarifa komunale për regjistrim të makinës	Drejtoria e Financave			Të rregullohet çështja e lirimit, siç duket ka raste individuale kur organizatat nuk lirohen.

Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës 2018 - 2020 është realizuar nga Handikos Prishtina, përkrahur nga Programi Angazhimi për Barazi - E4E, i cili financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID

dhe zbatohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC. Përmbytja e këtij Plani është përgjegjësi e Handikos Prishtina dhe OPAK dhe nuk pasqyron pikëpamjet e ATRC, USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



Handikos Prishtina falenderon Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara - OPAK që ishin pjesë e pandashme e gjithë kësaj

pune të draftimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Prishtinës 2018 - 2020.



A large, stylized, light blue graphic of a human figure with arms raised, set against a dark blue background. The figure is composed of smooth, rounded shapes, with a circular head and a wide, open mouth, suggesting a smile or a gesture of triumph. The figure is positioned centrally, behind the main text.

PLANI I VEPRIMIT

për Personat me Aftësi të Kufizuara
në Komunën e Prishtinës





HANDIKOS
PRISTINE

PLANI I VEPRIMIT

për Personat me Aftësi të
Kufizuara në Komunën
e Prishtinës

2018 - 2020

Shkurt 2018

